



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

KRYETARI

VENDIM

Nr. 28542 datë 17 7 2019

PËR

**NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
(PPV) TË BASHKISË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 23, pika 14, nenit 64, shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 13, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, nenit 12, të vendimit nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar, vendimit nr. 1, datë 14.04.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Tiranë", VKM Nr. 427, datë 08.06.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit; Udhëzimit nr. 1, datë 22.02.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar",

VENDOS :

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ky vendim të botohet në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELIAJ

